

QKB



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER NIKOLETA P. GJORDENI
ADRESA MYSLYM SHYRI, NR.30
TEL: 696051791

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 3111

Nr. koleksioni: 903


Tirane më 05/08/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2020053100080493906



A2020053100080493906

KONTRATË DHURIMI
TË KUOTAVE TË KAPITALIT

Në Tiranë, sot më datë **05.08.2020 (dymijë e njëzetë)**, përpara meje noteres publike **Nikoleta P. Gjordeni**, me zyre noteriale në rruga "Myslym Shyri", pall 30, kati 2, Anetare e Dhomes së Noterise Tirane, u paraqiten personalisht palet:

DHURUESI :

Znj. Era Xhabafti, atësia Arben, datëlindja 07/04/1989, vendlindja Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në adresën: Rruga "Nikolla Tupe", Pallati nr. 1/8, 1019, Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e dokumentit Letërnjoftim me numër BF1411665 dhe numër personal I95407051C, në cilësinë e njerit prej ortakëve të SHOQERISE "Vegetal Export" Sh.p.k., person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 17.09.2018, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me numër identifikimi (NUIS) L84517401V, me seli në adresën: Vajkan, Fier, Shqipëri, që këtu më poshtë do të përcaktohet si "Pala DHURUESE".

PRANUESIT E DHURIMIT:

Z. Eno Jegeni, atësia Suat, datëlindja 07/09/1976, vendlindja Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: Rruga "Thanas Ziko", Nr.25, Njësia Bashkiake Nr. 8, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit Letërnjoftim me numër O32851863 dhe numër personal H60907103N, në cilësinë e njerit prej ortakëve të SHOQERISE "Vegetal Export" Sh.p.k., person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 17.09.2018, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me numër identifikimi (NUIS) L84517401V, me seli në adresën: Vajkan, Fier, Shqipëri, që këtu më poshtë do të përcaktohet si "Pala PRANUESE E DHURIMIT".

Z. Abdurrahmon Zhubi, atësia Sadedin, datëlindja 10/10/1952, vendlindja Gjakovë Kosovë, shtetas kosovar, në adresën: "Përmet Vula" Nr. 12, Gjakovë, Kosovë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit Letërnjoftim me numër ID1094542, dhe numër personal 1002332031, në cilësinë e njerit prej ortakëve të SHOQERISE "Vegetal Export" Sh.p.k., person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 17.09.2018, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me numër identifikimi (NUIS) L84517401V, me seli në adresën: Vajkan, Fier, Shqipëri, që këtu më poshtë do të përcaktohet si "Pala PRANUESE E DHURIMIT".

Z. Almir Sahatajia, atësia Shpejtim, datëlindja 22/09/1977, vendlindja Gjakovë, shtetas kosovar, në adresën: Rruga "Anton Çeta" Nr. 63, Gjakovë, Kosovë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit Letërnjoftim me numër ID1090480, dhe numër personal 1001475785, në



cilesine e njerit prej ortakeve te SHOQERISE "Vegetal Export" Sh.p.k., person juridik shqiptar, i regjistruar me datën 17.09.2018, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me numër identifikimi (NUIS) L84517401V, me seli në adresën: Vajkan, Fier, Shqipëri, që këtu më poshtë do të përcaktohet si "Pala PRANUESE E DHURIMIT".

Palët kontraktuese, me vullnetine tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, bien dakord të hartojnë këtë **KONTRATË TRANSFERIMIT TË KUOTAVE TË KAPITALIT, NEPERMJET DHURIMIT**, sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme:

KUSHTE PARAPRAKE

Shoqëria "Vegetal Export" Sh.p.k., është nje person juridik shqiptar, i regjistruar me datën 17.09.2018, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, filiali Tiranë dhe e pajisur nga kjo zyrë me Çertifikatë Regjistrimi, Person i Tatueshëm, me numër identifikimi (NUIS) L84517401V, me seli në adresën: Vajkan, Fier, Shqipëri, me kapital të shoqërisë në shumën 100.000,00 Lekë (njëqindmijë), me ortakë të shoqërisë Z. Eno Jegeni, i cili zotëron 1 kuote qe perben 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë, Z. Abdurrahmon Zhubi, i cili zotëron 1 kuote qe perben 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë, Z. Almir Sahatqija, i cili zotëron 1 kuote qe perben 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë dhe Znj. Era Xhabafti, e cila zotëron 1 kuote qe perben 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë. Gjatë veprimtarisë së saj, Shoqëria "Vegetal Export" Sh.p.k. drejtohet prej Administratorit Z. Eno Jegeni.

Ortaku Znj. Era Xhabafti, kërkon të transferojë nepermjet dhurimit, kuoten dhe pjesën e zotëruar prej saj ne kapitalin e Shoqërisë "Vegetal Export" Sh.p.k., brenda shoqërisë, te tre oratket e tjere te saj dhe ortakët e shoqërisë janë plotësisht dakord që kjo të realizohet sipas kushteve dhe kërkesave të parashkruara në këtë kontratë.

Ortakët e shoqërisë "Vegetal Export" Sh.p.k., me Vendim të Asamblesë së Përgjithëshme të Ortakëve nr.4, të datës 05.08..2020, kanë vendosur lejimin e transferimit të kuotave të zotëruara nga ortaku Znj.Era Xhabafti, nëpërmjet dhurimit të 1 kuote , qe perben 10 % (dhjetë përqind) të kapitalit te zotëruar prej saj, në kapitalin e Shoqërisë "Vegetal Export" Sh.p.k, kuote kjo tërësisht të lira nga çfarëdolloj detyrimi në favor të ortakëve brenda shoqërisë, pa asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm mbi to, për transferimin e së cilave kanë shprehur interes dhe kane pranuar ortakët e tjerë të shoqërisë Z. Eno Jegeni, Z. Abdurrahmon Zhubi dhe Z. Almir Sahatqija.

Palët, me aftësi të plotë për të vepruar dhe me vullnet të lirë, pranojnë të lidhin këtë kontratë për Transferimin e kuotes nepermejt dhurimit, ne kapitalin e shoqërisë (këtej e tutje si "Kontrata"), sipas kushteve të mëposhtme:

NENI - 1 - OBJEKTI

Me anë të kësaj kontrate, **Pala Dhuruese, ortaku Znj. Era Xhabafti**, e cila zotëron 1 kuote qe perben 10% (dhjetë përqind) të kapitalit te shoqerise, me vlerë prej 10.000,00 (dhjetëmijë) Lekë, në kapitalin e shoqërisë "Vegetal Export" Sh.p.k., me dëshirën dhe kërkesën e saj, me vullnet te lire, te plote dhe te sinqerte, ne perputhje me Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe Statutit te Shoqerise, i dhuron dhe i transferon pa asnjë shpërblim ose vlerë brenda shoqërisë si me poshte:



1. **Dhurimin e 1 kuote, qe perben 3,33%**(tre presje tridhjetetë përqind) të pjesëve të saj, në kapitalin e shoqërisë, e barabartë me vlerën prej 3.330,00 (tremijë e treqind e tridhjetë) Lekë, të kuotes së saj në kapitalit e Shoqërisë "VEGETAL EXPORT" Sh.p.k, **te ortaku z. Eno Jegeni, pranues i dhurimit te kuotes, i cili pranon dhurimin e kuotes.**
2. **Dhurimin e 1 kuote, qe perben 3,34 %**(tre presje tridhjetekatër përqind) të pjesëve të saj, në kapitalin e shoqërisë, e barabartë me vlerën prej 3.340,00 (tremijë e treqind e dyzet) Lekë, të kuotes së saj në kapitalit e Shoqërisë "VEGETAL EXPORT" Sh.p.k, **te ortaku z. Abdurrahmon Zhubi, pranues i dhurimit te kuotes, i cili pranon dhurimin e kuotes.**
3. **Dhurimin e 1 kuote qe perben 3,33%**(tre presje tridhjetetë përqind) të pjesëve të saj, në kapitalin e shoqërisë, e barabartë me vlerën prej 3.330,00 (tremijë e treqind e tridhjetë) Lekë, të kuotes së saj në kapitalit e Shoqërisë "VEGETAL EXPORT" Sh.p.k. **te ortaku z. Almir Sahatqija, pranues i dhurimit te kuotes, i cili pranon dhurimin e kuotes.**

NENI - 2 - KALIMI I PRONËSISË

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhurimin për transferimit e kutave si më sipër, raporti i pronësisë së kuotave në kapitalin me vlerë të përgjithshme 100,000 (njëqindmijë) Lekë, të Shoqërisë "VEGETAL EXPORT" Sh.p.k, për ortakët do të jetë si më poshtë:

- Ortaku Z. Eno Jegeni, behet zotëruar i 1 (një) kuote, me vlerë të përgjithshme prej 33,330 (tridhjetetremijë e treqind e tridhjetë) Lekë, që përbën 33,33% (tridhjetetë presje tridhjetetë përqind), në kapitalin e shoqërisë "VEGETAL EXPORT" Sh.p.k;
- Ortaku Z. Abdurrahmon Zhubi, behet zotëruar i 1 (një) kuote, me vlerë të përgjithshme prej 33,340 (tridhjetetremijë e treqind e dyzet) Lekë, që përbën 33,34% (tridhjetetë presje tridhjetekatër përqind), në kapitalin e shoqërisë "VEGETAL EXPORT" Sh.p.k;
- Ortaku Z. Almir Sahatqija, është zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 33,330 (tridhjetetremijë e treqind e tridhjetë) Lekë, që përbën 33,33% (tridhjetetë presje tridhjetetë përqind), në kapitalin e shoqërisë "VEGETAL EXPORT" Sh.p.k.

NENI - 3 - GARANCITË

Dhuruesi posedon kuotën të lire nga çdo barre siguruese, peng, hipoteke, garanci pagese, barre mbi interesat, kufizim, opsion, pretendim, prokurë apo angazhime të tjera të çdo lloji natyre.

Nënshkrimi i kësaj kontrate nga dhuruesi dhe plotësimi i kushteve të saj nuk përbejnë shkelje apo janë në kundërshtim me normat e :

- (i) statutit të shoqërisë,
- (ii) ndonjë gjykim apo urdher, vendim gjyqësor, dekreti apo vendimi të çdo autoriteti vendas apo të huaj subjekti të cilin është shitës,
- (iii) ndonjë marrëveshje, licencë apo angazhim në të cilin këta shitës apo shoqëria është pale, që do të cenonte aftësinë e tij për të nënshkruar këto kontrate apo për të përmbushur detyrimet që rrjedhin prej saj,
- (iv) me ligjin e zbatueshëm

Pranuesit e dhurimit, deklarojnë se paraprakisht ka në verifikuar gjendjen financiare të shoqërisë dhe kanë dijeni të plote në lidhje me detyrimet dhe gjendjen e saj financiare dhe deklarojnë se njohin dhe pranojnë kuotat e mesipërme të dhuruara me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka në përpjestim me përqindjen e kuotave, duke mos pasur asnjë pretendim nga dhuruesi për periudhën që ka qenë ortak tani dhe në të ardhmen.



Kuotat nuk janë objekt i ndonjë kufizimi, barre apo pengu në favor të ndonjë pale të tretë.

Secila palë deklaron dhe garanton palën tjetër se kanë zotësi të plotë juridike për të nënshkruar dhe përmbushur Kontratën dhe se kushtet e parashikuara në Kontratë janë të detyrueshme për to.

NENI - 4 - BAZA LIGJORE

Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Për çdo mosmarrëveshje, që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose ekzekutimin e kësaj kontrate, versioni shqip do të jetë i vetmi version me efekt juridik provues për palët.

Kjo kontratë do të detyrojë palët dhe do të jetë e vlefshme midis tyre, ashtu si dhe për trashëgimtarët e tyre.

NENI - 5 - SHPENZIMET DHE TAKSAT

Shpenzimet legale dhe kontabile ashtu si edhe çfarëdo shpenzimi tjetër që lidhet me këtë kontratë, janë në ngarkim të të dyja palëve.

NENI - 6 - HARTIMI I KONTRATËS

Kontrata përbëhet nga 5(pese) fletë dhe hartohet në 5(pesë) kopje, të barazvlerëshme në gjuhën shqipe. Çdonjëra prej tyre ka përmbajtje të njëjtë ligjore dhe secila palë do të mbajë një kopje. Kopja e pestë depozitohet për regjistrim në zyrën e QKB-së.

NENI -7-FORCA MADHORE:

Mospërmbushja e kesaj kontrate nga njera pale nuk do te konsiderohet si shkelje e kesaj kontrate persakohe qe mospermbushja vjen si pasoje e nje ngjarje te konsideruar si force madhore, ne rastin kur provohet se pala e prekur nga kjo ngjarje:

(a) ka marre te gjitha masat e arsyeshme parandaluese, si dhe te gjitha masat e nevojshme per te permbushur kushtet dhe afatet e kesaj kontrate dhe

(b) ka informuar palen tjeter ne menyre te menjehershme per ndodhjen e kesaj ngjarje, Force Madhore do te konsiderohet cdo urdher, rregullore, direktive e qeverise e shpallur ne formen e ligjit apo ne nje forme tjeter, apo cdo lloj sanksioni me natyre kombetare apo nderkombetare, trazire, kryengritje popullore, lufte (e deklaruar apo jo) aksione terroriste apo guerrilase te grupeve apo individeve te vecante, grevave apo shqetesime te tjera te kesoj natyre, zjarre, termete apo cdo lloj shkakut tjeter qe nuk varet nga vullneti i paleve ose nuk vjen si pasoje e neglizhences se tyre qe ata nuk kishin mundesi ta parashikonin.

Cdo periudhe kohe brenda se ciles njera prej paleve, bazuar ne kete kontrate do te nderrmar ndonje veprim do te zgjatet ne nje menyre te barabarte me periudhen e kohes ne te cilen pala e kishte te pa mundur te vepronte si pasoje e Forces Madhore.

Ne rastet kur ngjarja e Forces Madhore zgjaten me shume se tre muaj rresht, secila pale mund ta zgjidhe ne menyre te njeanshme kete kontrate, pa asnje penalitet.

NENI - 8 – Te ndryshme

Kontrata e dhurimit te pasurise se luajtshme (kuota kapitali), nr. 2297 rep, nr.837 kol, date 17.07. 2020, nenshkruar nga palet e kesaj kontrata perpara noteres Majlinda Lleshi, Tirane, revokohet teresisht dhe nga ky moment nuk ka asnje vlere juridike dhe nuk sjell asnje pasoje juridike.



Neni -9- HYRJA NË FUQI DHE NËNSHKRIMI I KONTRATËS

Detyrimet dhe të drejtat që burojnë nga kjo Kontratë fillojnë efektet e tyre nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Kontrata e Dhurimit pasuri e luajtshme, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTORE

DHURUESI

ZNJ. ERA XHABAFTI

Era Xhabafti
EJ

PRANUESI I DHURIMIT PRANUESI I DHURIMIT PRANUESI I DHURIMIT

Z. ENO JEGANI Z. ABDURRAHMON ZHUBI Z. ALMIR SAHATQIJA

Eno Jegan
[Signature]

Abdurrahmon Zhubi
[Signature]

ALMIR SAHATQIJA
[Signature]

NOTER

NIKOLETA P. GJORDENI

